

**Vendim nr. 105 datë 06.07.2015**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (Kolegji), i përbërë nga:

Sokol Berberi,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Altina Xhoxhaj,	Anëtare e “ “
Gani Dizdari,	Anëtar i “ “

në datën 06.07.2015 mori në shqyrtim paraprak kërkesën me nr. 105 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** MARK FRROKU

**SUBJEKT I INTERESUAR**

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr.17, datë 03.04.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) si dhe ligji nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

Kolegji, pasi shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

1. Në datën 28.03.2015 Prokuroria e Përgjithshme ka regjistruar procedimin penal nr. 2, datë 28.03.2015 në ngarkim të shtetasve: a) *Mark FRROKU*, i biri i *Prengës dhe i Lezes*, lindur më 06.10.1972 në Pukë dhe banues në Tiranë; b) *Arjan BYTYCI* alias *Kristian MORINA (MARINAJ)* alias *Hile JOKA* alias *Hile MORINA*, lindur në Pukë në datë 02.02.1977 alias *Ilir*

*MORINA i lindur në Drenicë, Kosovë, më datë 2 Shkurt 1977, për veprën penale të “Vrasjes me paramendim e kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 78/1 dhe 25 të Kodit Penal. Procedimi penal nr.2, i mësipërm, është regjistruar mbi bazën e materialeve të ardhura nga Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana me shkresën nr.2851/1 KL Prot.BM/FKB 1433/15, datë 27.03.2015 dhe nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr.266/2, datë 28.03.2015.*

2. Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana, me shkresën nr.2851/1 KL Prot.BM/FKB 1433/15, datë 27.03.2015, ka komunikuar se shtetasi shqiptar Mark Frroku, lindur më 06.10.1972, në Këcirë – Pukë, alias Besnik Morina, është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet belge të drejtësisë, mbi bazën e Urdhrit të Arrestit Ndërkombëtar me nr.B1/07 OPC, lëshuar më datë 03.12.2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Brukselit, Belgjikë, për veprën penale të “*Vrasjes si pasojë e plagëve të marra*”, parashikuar nga nenet 66 dhe 394 të Kodit Penal Belg, vepër për të cilën parashikohet një dënim maksimal me burgim të përjetshëm. Shkresës së Zyrës Qendrore Kombëtare të Interpol Tiranës i është bashkëlidhur dokumentacioni i mëposhtëm: *Kopje e Urdhrit të Arrestit Ndërkombëtar (kartela Red Notice) me nr.control No: A-109/1-2015, lëshuar nga Interpol Bruksel, më datë 08.01.2015; kopje e rezultateve të nxjerra nga kontrolli në sistemin e-ASF2 të Interpolit; fotokopje e pasaportës me nr.BI9965569, lëshuar në emër të Mark Frrokut (të dhënat e nxjerra nga Sistemi i Administrimit Total të Informacionit - TIMS).*

3. Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr.266/2 datë 28.03.2015, ka përcjellë shkresën nr.2851/1 KL Prot.BM/FKB 1433/15, datë 27.03.2015 të Zyrës Qendrore Kombëtare Interpol Tirana mbi shpalljen në kërkim ndërkombëtar të shtetasit shqiptar Mark FFROKU (FRROKU) alias Besnik MORINA. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë ka komunikuar se duke marrë në konsideratë urdhrin e arrestit ndërkombëtar, bazuar në nenin 38 të ligjit nr.10193, datë 03.12.2009 “*Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale*”, mbetet në pritje të veprimeve për të komunikuar më tej me Autoritetet Belge.

4. Prokuroria e Përgjithshme, duke vlerësuar argumentat e parashtruara nga Autoritetet Belge të drejtësisë, të përcjella nëpërmjet ZQK Interpol-Tirana dhe Ministrisë së Drejtësisë, mbështetur në nenin 6 të Kodit Penal, nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe pikën 7 të nenit 38, të ligjit nr.10193, datë 3.12.2009 “*Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale*”, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal në regjistrin e njoftimit të

veprave penale të Prokurorisë së Përgjithshme, për veprën penale “*Vrasje me paramendim*” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 78/1 dhe 25 të Kodit Penal.

5. Në vijim organi i Prokurorisë së Përgjithshme ka komunikuar drejtpërdrejt me Autoritetet Belge të drejtësisë të cilat kanë dërguar Akt-Akuzën në ngarkim të shtetasit Mark Frroku. Këto autoritete kanë dhënë miratimin për përdorimin e këtij Akti nga autoritetet shqiptare. Me qëllim për t’i hapur rrugë një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të këtij rasti, prokuroria, bazuar në nenet 73/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar nga Kuvendi autorizimin për arrestimin ose heqjen e lirisë së shtetasit Mark Frroku, Deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

6. Me vendimin nr.42 datë 02.04.2015, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar kërkesën e prokurorisë për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Mark Frroku.

7. Gjithashtu, në ngarkim të Mark Frrokut është regjistruar procedimi penal nr.3, datë 01.04.2015, për veprat penale: “*Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe “*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*”, parashikuar nga neni 257/a/2” i Kodit Penal.

8. Ky procedim është regjistruar mbi kërkesën e Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili ka dërguar “*Kërkesën për fillimin e ndjekjes penale*” ndaj shtetasit Mark Frroku, me funksion deputet i Kuvendit të Shqipërisë, për veprën penale të “*Refuzimit për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim*”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal. Në kërkesë janë parashtruar dyshimet për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal nga ana e shtetasit Mark Frroku, pasi në “*Deklaratën e interesave private para Fillimit të Detyrës*” në vitin 2013, subjekti deklarues ka deklaruar pasuri në shuma të konsiderueshme për të cilat ka refuzuar burimin e krijimit të tyre.

9. Nisur nga fakti se subjekti ka refuzuar burimin e deklarimit të pasurive krijohen dyshime të arsyeshme se subjekti deklarues ka fshehur pasuri të tjera të padeklaruara. Gjithashtu, në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2014, subjekti ka deklaruar pasuri në vlera të konsiderueshme të cilave sërish nuk i ka deklaruar burimin e krijimit të tyre.

10. Në datën 01.04.2015 është vendosur bashkimi i të dy procedimeve të mësipërme duke u numërtuar procedimi penal nr.2, viti 2015, nisur nga fakti se të dy procedimet penale bëjnë fjalë për të njëjtin person, i cili ka kryer disa vepra penale që lidhen midis tyre.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.17, datë 03.04.2015, ka vendosur: *“Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit të shtetasit Mark Preng Frroku. Caktimin e masës së sigurimit personal “Arrestit në burg”, parashikuar nga neni 238 i KPP për shtetasin Mark Preng Frroku, i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga nenet 78/1 dhe 25 të Kodit Penal.”.*

## II

12. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me pretendimin se këto vendime i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi:

12.1. Ndjekja penale e kërkuesit është bërë në kundërshtim me Kushtetutën duke qenë se nuk është marrë autorizimi nga Kuvendi i Shqipërisë për fillimin e ndjekjes penale të deputetit. Kuvendi ka dhënë vetëm autorizimin për arrestimin jo për ndjekjen penale edhe për vepra të tjera si refuzimi për deklarin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive;

12.2. Vendimi i Kolegjit Penal është marrë në kundërshtim me Konventën e Këshillit të Europës “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale”, pasi nuk mund të fillojë asnjë çështje penale pa vendim të transferimit të procedimit penal apo kërkesë të shtetit kontraktues. Për këtë shkak, Kolegji Penal nuk mund të vendoste masën e arrestit përderisa mungon vendimi i transferimit të procedimit penal.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

13. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet të vejë në lëvizje Gjykatën dhe të parashtrijë pretendimet e tij me natyrë kushtetuese para saj, kur ato lidhen me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës. Kërkesa gjithashtu është paraqitur

brenda afatit 2 vjeçar. Kolegji vlerëson se Gjykata është kompetente të shqyrtojë çështjen për shkak se kërkuesi nuk ka asnjë mjet tjetër efektiv për realizimin e së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor. Kërkuesi i ka shterruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion.

14. Për sa i takon bazueshmërisë së pretendimit për antikushtetutshmëri të vendimit, pasi bie ndesh me nenin 73 të Kushtetutës, Kolegji çmon se ai nuk qendron. Kërkuesi, nëpërmjet avokatëve të tij, më shumë se një herë, në kërkesën e tij i referohet nenit 73/2 para ndryshimeve kushtetuese të vitit 2012<sup>1</sup>, me anë të cilave është hequr dhënia e autorizimit nga Kuvendi për *ndjekjen penale* të deputetëve duke lënë vetëm rastet e *a) arrestimit dhe b) të kontrollit personal dhe të banesës*, të cilat në çdo rast kanë nevojë për dhënien e autorizimit nga Kuvendi. Pra, dhënia e autorizimit për ndjekjen penale të deputetit nuk është më detyrim kushtetues, prandaj kërkuesi nuk mund t'i referohet më asaj dispozite. Me të drejtë prokuroria në kërkesën e saj i është drejtuar Kuvendit për dhënien e autorizimit për arrestimin e kërkuesit dhe jo për ndjekjen penale të tij, gjë të cilën ajo (prokuroria) mund ta fillojë pa autorizimin e Kuvendit.

15. Lidhur me pretendimin se vendimi i GJL për masën e arrestit bie ndesh me Konventën e Këshillit të Europës për transferimin e procedimeve penale, Kolegji çmon se edhe ky nuk është i bazuar. Së pari, kuptimi i dhënë dispozitave të cituara nga kërkuesi nuk i përgjigjen tekstit origjinal të Konventës. Së dyti, nga materialet e dosjes dhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë rezulton se masa e arrestit ndaj kërkuesit nuk është marrë vetëm për llogari të shtetit belg por edhe për llogari të hetimeve të nisura nga prokuroria shqiptare për veprën penale të *“Refuzimit për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”*, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal. Prandaj, çështja e masës së sigurisë të vendosur ndaj kërkuesit duhet parë për të gjitha hetimet e nisura ndaj tij, siç ka arsyetuar me të drejtë edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

16. Si përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

---

<sup>1</sup> Ndryshime të bëra me ligjin nr.88/2012.

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.